

## **Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore zhvillon workshop-in “Për përgatitjen e planit të auditimeve të KLSH-së, për vitin 2024”**

**27.10.2023**

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore zhvilloi në datën 27.10.2023 në ambientet e KLSH-së, workshop-in “Për përgatitjen e planit të auditimeve për vitin 2024”.

Duke pasur në konsideratë faktin se përfshirja e shumë strukturave së bashku, si dhe e të gjithë audituesve në këtë proces diskutimi çon në një planifikim më efektiv dhe më të mirë, në workshop, përveç audituesve të Departamentit, morën pjesë edhe përfaqësues të Departamentit të Metodologjisë, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit.

Workshop-i kishte për qëllim gjenerimin e ideve dhe marrjen e propozimeve konkrete nga të gjithë audituesit për hartimin e planit vjetor të auditimeve për vitin 2024.

Diskutimet për hartimin e këtij plani u bënë duke u mbështetur në Metodologjinë e Planifikimit Vjetor të Auditimeve.

Nisur nga fakti se në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50, pika 1, përcaktohet se: “*Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njësive të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm*”, për auditimet financiare u diskutua mbi kapacitetet e burimeve njerëzore të Departamentit për mbulimin e këtyre auditimeve në 61 bashkitë e vendit, si dhe mënyra e formimit të grupeve të auditimit, duke patur parasysh kombinimin e audituesve sipas formimit profesional, si dhe kombinimin e audituesve të rinj me ata me më shumë përvojë, në mënyrë që kjo t’i shërbejë mbulimit dhe trajtimit sa më të mirë të pikave të programit të auditimit.

Në workshop u diskutua për risqet që duhen konsideruar dhe vlerësuar nga Departamenti, mbi bazën e të cilëve do të përcaktohen subjektet që do të planifikohen për kryerjen e auditimit të përputhshmërisë.

Indikatorët të cilët u patën në konsideratë për subjektet që do të përfshihen në planin vjetor të auditimeve për vitin 2024, janë: shpenzimet faktike; anomali serioze nga auditimet e mëparshme; pritsshmëritë e grupeve të interesit; datat e auditimit të fundit të kryer në subjekt; ndjeshmëria e fushës ku operon subjekti etj.

Gjithashtu u diskutua jo vetëm për planin vjetor në kuadër të përzgjedhjes së subjekteve, por edhe lidhur me hartimin e programeve të auditimit, identifikimin në pika më vetë në këtë program të çështjeve të rëndësishme dhe të ndjeshme, si çështja e menaxhimit të aseteve nga subjektet dhe procesi i regjistrimit të tyre në ASHK.

Duke qenë se një planifikim i mirë duhet të ndiqet nga një zbatim i mirë i planit të hartuar, në këtë takim pune u bë edhe një përmbledhje e arritjeve të Departamentit për periudhën janar-tetor 2023, si dhe u evidentuan dobësitë e shfaqura gjatë procesit të auditimit sipas fazave të tij.

U vu theksi në rritjen e cilësisë së auditimit nga të gjithë audituesit, në mënyrë që çdo auditim të kryhet në përputhje të plotë me “Rregulloren e procedurave të auditimit” të KLSH-së.

Diskutimet e bëra në këtë workshop do t’ju shërbejnë drejtuesve të Departamentit për hartimin e planit vjetor të auditimeve për vitin 2024.